



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Data e dorëzimit të Raportit / Date of Report Submission		30.11.2018	
Organizimi / Organization	Numri i Protokollit / Protocol Number	Titulli / Title	Numri i Dokumentit / Document Number
SKPM/SHCK	7246/2018	111	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 336 /2018

Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Vendimi i dërgohet:


- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe
- Arkivit të Këshillit.

Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Primesha / Dodrësor Primesha / Dodrësor Primesha / Dodrësor	30 - 11 - 2018	8
Organizues Organizues Organizues	Nr. Prot. Nr. Prot. Nr. Prot.	Prilog Prilog Prilog
Organizim Organizim Organizim	Prot. No. Prot. No. Prot. No.	Prilog Prilog Prilog
SKPMSHCK	7246/2018	1113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL
NË
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË
PËR VITIN
2017

Prishtinë, 2018

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
FUNKSIONI MBIKQYRËS I KËSHILLIT	3
OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES	3
FUSHAT E MBIKËQYRJES.....	4
RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË MINISTRINË E TREGTISË DHE INDUSTRIË.....	5
I. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE.....	8
II. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT	8
III. PROCEDURAT DISIPLINORE	9
IV. PROCEDURAT E ANKESAVE.....	9
V. PROCEDURAT E VLERËSIMIT.....	10
VI. PROCEDURAT E PUSHIMEVE	10
VII. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT.....	11
VIII. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA	11
IX. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS.....	12
X. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK	12
XI. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS.....	12
XII. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL	12
XIII. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET	13
XIV. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT.....	13
XV. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLuzionET E PËRGJITHSHËM PËR MIBKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL	13

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Rregullorja Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI MBIKQYRËS I KËSHILLIT

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar “Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil”, mbi bazën e të cilit edhe harton “Planin e Mbikëqyrjes” në kuadër të të cilit përfshihen një numër i Institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre Institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim viti.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektiva e mbikëqyrjes ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësi për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli, gjatë implementim të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të Institucioneve të cilët janë përgjegjës për zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Në këtë kuadër si pjesë e mbikëqyrjes janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË MINISTRINË E TREGTISË DHE INDUSTRIË

Këshilli, gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë me datë 12.07.2018, në prezencë të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Vendimi me numër të protokollit 1351 i datës 04.09.2017 për emërimin e ushtruesit të detyrës;
- Vendimi me numër të protokollit 1080 i datës 21.12.2017 për emërimin e ushtruesit të detyrës;
- Dosja e personale e nëpunësës “Zyrtare për Politika Turistike” në Departamentin e Industrisë;
- Vendimi Nr.02Ref.332 i datës 06.10.2016 për formimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Vendimi Nr.02.Ref.20 i datës 27.01.2017 për themelimin e Komisionit Disiplinor;
- Dosja e procesit të rekrutimit për vendin e punës “Zyrtar i Lartë për Mbrojtjen e Konsumatorit”;
- Dosja e procesit të rekrutimit “Zyrtarë i Lartë për Akreditimin e Trupave Inspektues dhe Certifikues”;
- Vlerësimi i punës për vitin 2017 për nëpunësin në vendin e punës “Drejtor i Përgjithshëm” në Agjencinë për Pronësi Industriale;
- Vlerësimi i përgjithshëm i vitit 2017 i performancës së punës për nëpunësin “Kryeshëf i Agjencisë Kosovare për Standardizim”;
- Vlerësimi i punës për vitin 2017 për nëpunësen në vendin e punës “Drejtor i Përgjithshëm” në Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë;
- Ndryshim dhe plotësimi i akt emërimit i nëpunësit në vendin e punës “Udhëheqës i Divizionit për Rregullimin e Tregut të Naftës”;
- Pushimi mjekësor i nëpunësit në vendin e punës “Zyrtar i Lartë Ligjor”;
- Pushimi mjekësor i nëpunësit në vendin e punës “Zyrtarë e Lartë Ligjore për Legjislacion me BE-në”;
- Pushimi mjekësor i nëpunësit në vendin e punës “Zyrtare e Lartë për Zhvillimi” në KIESKA;
- Pushimi mjekësor i nëpunësit në vendin e punës “Zyrtare për Dokumentacion dhe Informim” në Agjencinë e Pronësisë Industriale;
- Vendimi me numër 741 i datës 24.05.2016 për pushim pa pagesë;

- Vendimi me numër 617 i datës 21.04.2017 për pushim pa pagesë;
- Vendimi me numër 1719 e datës 10.11.2016 për pushim pa pagesë;
- Vendimi me numër 555 i datës 11.04.2017 për lejimin e pushimit të lehonisë;
- Vendimi me numër 317 i datës 03.03.2017 për pushimin e lehonisë;
- Vendimi me numër 1872 i datës 05.12.2016 për lejimin e pushimit të lehonisë;
- Vendimi me numër 1144 i datës 29.07.2016 për lejimin e pushimit të lehonisë;
- Vendimi me numër 348 i datës 09.03.2017 për lejimin e pushimit të lehonisë;
- Vendimi me numër 992 i datës 07.07.2016 për pushimin e lehonisë;
- Vendimi me numër 532 i datës 07.04.2017 për transferim;
- Dosja personale e nëpunësit në vendin e punës “Zyrtar për Përfaqësim të Komuniteteve dhe Mundësi të Barabarta”;
- Dosja personale e nëpunësit në vendin e punës “Zyrtar i Metrologjisë për Madhësi Mekanike-Prizren”;
- Dosja personale e nëpunëses në vendin e punës “Asistente Administrative”;
- Dosja personale e nëpunësit në vendin e punës “Ndihmës Zyrtarë për promovimin e investimeve KIESKA”;
- Vendimi me numër 1335 i datës 27.12.2013 për pezullim të dakorduar;
- Vendimi me numër 21 i datës 13.01.2015 për pezullim të dakorduar;
- Vendimi me numër 142 i datës 07.02.2014 për pezullim të dakorduar;
- Vendimi me numër 1561 i datës 08.10.2015 për pezullim;
- Vendimi me numër 321 i datës 02.03.2016 për pezullim;
- Vendimi me numër 322 i datës 02.03.2016 për pezullim;
- Vendimi me numër 441 i datës 24.04.2014 për pezullim;
- Vendimi me numër 1791 i datës 04.11.2015 për pezullim;
- Vendimi me numër 717 i datës 30.04.2015 për pezullim;
- Vendimi me numër 2143 i datës 21.12.2015 për pezullim;
- Vendimi me numër 1702 i datës 02.11.2017 për pensionim;
- Vendimi me numër 676 i datës 03.05.2017 për pensionim;
- Vendimi me numër 169 i datës 08.02.2017 për dorëheqje;
- Vendimi me numër 1695 i datës 01.11.2017 për dorëheqje;
- Vendimi me numër 1153 i datës 25.07.2017 për dorëheqje;

- Akt emërimi i nëpunësit “Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informativë”;
- Anulimi i konkursit për vendin e punës “Zyrtar Ligjor”;
- Anulimi i konkursit për vendin e punës “Udhëheqës i Drejtoratit për Standarde, Promovim dhe Integrim”;
- Anulimi i konkursit për vendin e punës “Zyrtar i Lartë për Ekzaminim”;
- Anulimi i konkursit për vendin e punës “Zyrtar për informim dhe monitorim të mediave”;
- Anulimi i konkursit për vendin e punës “Drejtor i Drejtoratit të Akreditimit dhe të Zhvillimit”;
- Anulimi i konkursit për vendin e punës “Zyrtar i Logjistikës 1”;
- Anulimi i konkursit për vendin e punës “Zyrtar për Metrologji”;
- Anulimi i konkursit për vendin e punës “Zyrtar për informim dhe monitorim të mediave”;
- Anulimi i konkursit për vendin e punës “Zyrtare e Pasurisë”;
- Anulimi i konkursit për vendin e punës “Udhëheqës i Sektorit për Zhvillimin e Zonave Ekonomike”;
- Anulimi i konkursit për vendin e punës “Asistente Ekzekutive”;
- Vendimi i datës 24.10.2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Vendimi i datës 12.12.2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Vendimi i datës 13.10.2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Dosja e procesit të rekrutimit “Zyrtar i Logjistikës 2”;
- Marrëveshjet për shërbime të veçanta për vendin e punës “Zyrtar për marka tregtare”
- Marrëveshjet për shërbime të veçanta për vendin e punës “Mbikëqyrës i Projekteve Kapitale në Kuadër të KIESKA”;
- Marrëveshjet për shërbime të veçanta për vendin e punës “Ekspert Ligjor”;
- Marrëveshjet për shërbime të veçanta për vendin e punës “Zyrtar i Prokurimit”;
- Marrëveshjet për shërbime të veçanta për vendin e punës “Zyrtar për shqyrtimin dhe aprovimin e lëndëve”;
- Dosja e procesit të rekrutimit “Zyrtar Ligjor 2”;
- Dosja e procesit të rekrutimit “Zyrtar i Pasurisë”
- Vendimi me numër 06/194 i datës 23.07.2014.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

I. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë më datë 12.07.2018, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren për Organizimin e Brendshme dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës e cila zbatohet që nga vitit 2012, mirëpo nuk ka përfunduar ende klasifikimi dhe sistematizimi i vendeve të punës sepse iu ka ndaluar Ministria e Administratës Publike. Akt emërimet e nëpunësve civile janë në pajtim me organizimin e brendshëm, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, numrin e nëpunësve civil të miratuar me buxhet e ka 231 dhe se 23 pozita janë të lira.

Ushtuesit e detyrës: Kolegji duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në këtë institucion gjatë vitit 2017 ka pasur njëzet e tre (23) pozita me Ushtues të Detyrës dhe si mostra ka marrë tri (3) vendime të ushtuesve të detyrës për vendin e punës: “Udhëheqës i Sektorit për Zhvillimin e Zonave Ekonomike” në Agjencinë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve; “Udhëheqës e Divizionit të Turizmit” në Departamentin e Industrisë dhe “Udhëheqës i Departamentit për Rezerva Shtetërore”, ushtuesit e detyrës kanë qenë të caktuar për një periudhë kohore për tre muaj, ashtu siç është përcaktuar me nenin 30 paragrafin 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

II. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ka përgatitur planin vjetor të rekrutimit dhe ka zhvilluar njëzet e pesë (25) procedura të rekrutimit, prej tyre njëmbëdhjetë (11) procedura të brendshme dhe katërmëdhjetë (14) të jashtme.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, si mostër ka marrë procesin e rekrutimit për vendin e punës “Zyrtarë i Lartë për Akreditimin e Trupave Certifikues”, “Zyrtar i Pasurisë”, “Zyrtar Ligjor 2”; “Zyrtar i Logjistikës 1” dhe Kolegji ka konstatuar se procedurat e rekrutimit të zhvilluara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

Marrëveshjet për shërbime të veçanta: Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, gjatë vitit 2017 ka pasur njëzet (20) të angazhuar nëpunës me shërbime të veçanta, për të cilët janë zhvilluar procedurat e shkurtuara të rekrutimit.

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të marrëveshjeve për shërbime të veçanta për vendin e punës “Zyrtarë për shqyrtimin dhe aprovimin e lëndëve” është nënshkruar me datë 14.07.2017 dhe ende vazhdon të punoj me marrëveshje për shërbime të veçanta, Kolegji ka konstatuar se për pozitën e lartë cekura Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e ka vepruar në kundërshtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Sekretaren e Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljes, që të zhvillohen procedurat e thjeshtësuara të rekrutimit ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit Nr.3/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

E GJETURA 2: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të marrëveshjeve për shërbime të veçanta për vendin e punës “Ekspert Ligjor”, ka konstatuar se marrëveshja është nënshkruar me datë 25.10.2017 dhe enda vazhdon të punoj me marrëveshje për shërbime të veçanta, pastaj kandidatja e punësuar sipas marrëveshjes për shërbime të veçanta për vendin e punës “Zyrtar i prokurimit”, konstaton se kontrata për marrëveshje të shërbime të veçanta për vendin e punës “Zyrtare e Prokurimit” është nënshkruar më datë 06.09.2017 dhe ende vazhdon të punojë me marrëveshje për shërbime të veçanta si dhe këto pozita janë të lidhura për pozita të shërbimit civil.

Kolegji ka konstatuar që në bazë të nenit 12 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ekzistojnë dy kategori të të punësuarve: **„pozitat e nëpunësve civilë të karrierës dhe pozitat e nëpunësve civilë të jo karrierës”.**

Në kuptim të kësaj dispozite, pozitat e nëpunësve civil të karrierës apo të jo karrierës, nuk mund të plotësohen me nëpunës me kontrata për marrëveshje për shërbime të veçanta.

REKOMANDIMI 2:

Rekomandojmë Sekretaren e Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që me rastin e lidhjes së Kontratave me marrëveshjeve për shërbime të veçanta duhet pasur parasysh që të njëjtat nuk mund të lidhen marrëveshje të tilla por duhet ndjekur procedurat e parapara me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

III. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor është i themeluar me Vendimin me numër 02/Ref.20 të datës 27.01.2017 dhe është në pajtim me dispozitat e nenit 70 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Komisioni Disiplinor, i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, gjatë vitit 2017 nuk ka pas raste për shqyrtim.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

IV. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është i themeluar me Vendimin me numër 02.Ref.332 të datës 06.10.2016 dhe është në pajtim me dispozitat e nenit 82 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se gjatë vitit 2017 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ka pas nëntëmbëdhjetë (19) raste për shqyrtim në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave dhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave ka vendosur për tetëmbëdhjetë (18) raste e që është në kundërshtim me nenin 9 paragrafin 7 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjen së Kontesteve dhe të Ankesave.

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të lëndëve të paraqitura në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave nuk ka vendosur për ankesën e ankueses e sistemuar në vendin e punës “Inspektore e Tregut” në Komunën e Graçanicës, pastaj për këtë rast ka vendos Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me ankesën me numër A/02/277/2017 të datës 23.08.2017.

REKOMANDIMI 3:

Rekomandojmë Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për eliminimin e shkeljes dhe ankesat të cilat paraqiten nga nëpunësit civilë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave duhet të shqyrtohen nga ky komision dhe të merret vendim brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh në pajtim me nenin 9 paragrafin 7 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjen së Kontesteve dhe të Ankesave.

V. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, nuk e ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civilë.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në dosje personale të nëpunësit civil në vendin e punës “Udhëheqës i Divizionit për Rregullimin e Tregut të Naftës”, nuk është bërë vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2017 edhe pse Zyra e Burimeve Njerëzore më datë 16.11.2017 ka përcjell e-mailin tek udhëheqësit e drejtpërdrejtë të nëpunësve civil që vlerësimet duhet të bëhet deri më datë 31.12.2017, pastaj me datë 01.12.2017 dhe 15.12.2017 iu ka rikujtuar për vlerësimin e punës për vitin 2017 që duhet t’iu bëhet nëpunësve civilë.

REKOMANDIMI 4:

Rekomandojmë Sekretaren e Përgjithshëm, Udhëheqësit e drejt për drejt të nëpunësve civil në Ministrinë së Tregtisë dhe Industrisë, që të ndërmarr veprimet ligjore për eliminimin e shkeljeve dhe që për të gjithë nëpunësit civil të bëhet vlerësimi i punës nga udhëheqësit e drejtpërdrejtë të tyre ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe me dispozitat e nenit 3 paragrafit 1.4 dhe 1.5 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civilë.

VI. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, evidencën e pushimeve të nëpunësve civil e mban në formë fizike

dhe elektronike, ndërsa 84 nëpunës civil kanë shfrytëzuar pushimin mjekësor, 3 nëpunës pushim pa pagesë dhe 7 nëpunës pushimin e lehonisë. Të gjitha pushimet janë në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

VII. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë gjatë vitit 2017 ka pasur një (1) transferim të brendshëm, e cili transfer është bërë në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

VIII. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ka të punësuar 221 nëpunës civil, prej tyre 24 serb, 1 egjiptian, 1 turk dhe 1 boshnjak, prej 221 nëpunësve civil 74 janë të punësuar femra ndërsa 147 janë meshkuj ndërsa në këtë institucion nuk ka asnjë nëpunës civil i punësuar nga personat me aftësi të kufizuara.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 221 nëpunësve civil të punësuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, 74 prej tyre janë të punësuar femra ndërsa 147 janë të punësuar meshkuj, çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të punësuarve në aspektin gjinor ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore.

REKOMANDIMI 5:

Rekomandojmë Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 221 nëpunësve civil të punësuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, me çka nënkuptohet se nuk është respektuar dispozita e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, sipas të cilës dispozitë është përcaktuar që „Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor”.

REKOMANDIMI 6:

Rekomandojmë Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara pasi që çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor.

IX. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në këtë institucion dhjetë (10) nëpunës civilë janë të pezulluar, prej tyre tre (3) nëpunës civil janë më pezullim të dakorduar, tre (3) nëpunës me pushim pa pagesë, tre (4) nëpunës kanë marrë detyrat e funksionarit publik, tetë (8) nëpunës civil janë me pezullim parandalues, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2017 kanë qenë dhjetë (10) ndërprerje të marrëdhënies së punës prej tyre, shtatë (7) ndërprerje të marrëdhënies së punës për shkak të dorëheqjes, dy (2) nëpunës civil për shkak të arritjes së moshës së pensionimit dhe një (1) përfundim i afatit për punësim me afat të caktuar. Kolegji ka konstatuar se ndërprerja e marrëdhënies së punës për nëpunësit civilë është bërë në pajtim me dispozitat e ligjore të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

X. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Ministrinë e Tregtisë, kemi tre (3) nëpunës civilë të cilët janë emëruar/zgjedhur në funksione publike dhe të cilët i kanë pezulluar vendet e tyre të punës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

XI. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në vitin 2017 nuk ka nëpunës ndaj të cilëve është filluar procedura penale.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

XII. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ka përgatit planin individual të trajnimeve për secilin nëpunës sipas Formularit 3, plani është përgatitur në muajin shkurt të vitit 2017 dhe në muajin shkurt është

dorëzuar në MAP/DASHC si dhe IKAP/DASH-ja i ka pas parasysh kërkesat e institucionit për plan të trajnimeve. Evidencat e trajnimeve të nëpunësve civil mbahen në formë fizike dhe elektronike dhe për vitin 2017 njëzet (20) nëpunës kanë ndjekur trajnime.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

XIII. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, vijimin në punë e mban në formë elektronike. Po ashtu në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohet në pajtim me akt emërimet, ndërsa shtesat apo kompensimet tjera realizojnë zyrtarët e Teknologjisë Informative.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

XIV. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, i ka zbatuar të gjitha vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nuk ka ngritur asnjë padi ndaj vendimeve të Këshillit.

XV. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLuzionET E PËRGJITHSHËM PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit dhe monitorimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes, ka konstatuar gjashtë (6) të gjetura dhe ka dhënë gjashtë (6) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Lela Petković

Kryetare e Kolegjit



Valentina Kaçandolli Bektashi

Bashkëpunëtore Profesionale